

LIGJ
Nr.8369, datë 9.7.1998

**PËR TRAJTIMIN E FATURAVE TË KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË
NGARKIM TË SUBJEKTEVE SHTETËRORE (BUXHETORE DHE JOBUXHETORE)
DHE TË SUBJEKTEVE PRIVATE SI TITUJ EKZEKUTIVË**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Fatura tatimore e konsumit të energjisë elektrike, e lëshuar nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) në ngarkim të subjekteve shtetërore, buxhetore dhe jobuxhetore e të subjekteve private, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", konsiderohet titull ekzekutiv.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2159, datë 20.7. 1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**